



Breaking News: Drejtoria Vendore e Policisë Fier, gjatë 24 orëve të fundit

|| ◀ ▶

LajmetOperacionet

25/10/2024

DVP Gjirokaštër – Finalizohet Operacioni Policor Antidrogë I Koduar “Andromeda”

DVP Gjirokaštër/Finalizohet pas disa javësh hetime me metoda proaktive, operacioni policor antidrogë i koduar “Andromeda”.

Të organizuar si grup siguronin Kokainë dhe Cannabis, si dhe i shitnin në doza, në Gjirokaštër dhe në Sarandë, vihen në pranga 3 shtetas.

Njëri nga të arrestuarit kishte në banesë doza të lëndëve narkotike, armë gjahu, municion luftarak, radio marrëse-dhënëse dhe mallra të kontrabanduara.

2 të arrestuarit e tjerë u kapën në flagrancë me doza të lëndëve narkotike dhe me shuma parash në valuta të ndryshme, të fituara nga shitja e dozave.

Sekuestrohen doza Cannabis, rreth 50 gramë Kokainë, 1 armë gjahu, 1 radio marrëse-dhënëse, një sasi municioni, 250 paketa me cigare (pa pullën fiskale), shuma parash në valuta të ndryshme, 4 celularë dhe 2 automjete.

Si rezultat i një hetimi me metoda proaktive, të kryer për disa javë, në drejtimin e Prokurorisë së Gjirokastrës, pas informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, për implikimin e disa shtetasve në veprimtarinë kriminale të shitjes së lëndëve narkotike, në doza, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Sektorin Operacional të DVP Gjirokaštër dhe me Forcën e Posaçme Operacionale të DPPSh-së, finalizoi operacionin policor të koduar “Andromeda”.

Gjatë operacionit u arrestuan në flagrancë shtetasit M. S., 45 vjeç, banues në Gjirokaštër, K. K., 45 vjeç, banues në Ksamil dhe K. Xh., 41 vjeç, banues në Sarandë.

Nga hetimet ka rezultuar se këta 3 shtetas, të organizuar si grup, shitnin doza të lëndëve narkotike Kokainë dhe Cannabis, në Gjirokaštër dhe në Sarandë. Lëndët narkotike siguroheshin kryesisht nga shtetasi M. S., të cilit nga kontrolli në banesë, iu gjetën sasi të tyre, të ndara në doza, armë gjahu, municion luftarak dhe 1 radio marrëse-dhënëse, të poseduara pa leje, si dhe 250 paketa me cigare, të dyshuara të kontrabanduara, pasi nuk ishin të pajisura me pullën fiskale. Ndërkaq, 2 të arrestuarit e tjerë u kapën në flagrancë me doza Kokaine dhe Cannabis, si dhe me shuma parash, në lekë, euro dhe paunde, të dyshuara të përfituara nga shitja e dozave.

Në vijim të veprimeve procedurale në kuadër të këtij operacioni, nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin V. K., 31 vjeç, banues në Gjirokaštër, pasi nga kontrolli fizik, iu gjet një sasi e vogël lënde narkotike Cannabis Sativa.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaštër, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)